



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 1601/Prot.

Berat, më 12/032026

V E N D I M
Nr. 216 datë 12/03/2026
PËR

SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108, datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil”, vendimit nr.832 date 05.12.2025 “Për miratimin e Strukturës, Organogramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësisë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, për vitin 2026, i ndryshuar si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil, Kryetari i Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Numri i vendeve vakante që i shtohen planit vjetor të pranimit në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2026 do të jetë **1(një)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtëme :
 - a)Për kategorinë ekzekutive 1(një) pozicion vakante
 - *Specialist Buxheti, Sektori i Planifikimit dhe Zbatimit të Buxhetit në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit. Kategoria IV, klasa e pagës IV-2.*
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e Njësisë Përgjegjëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin Ceca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 1601/2 Prot.

Berat, më 12/03 2026

Lënda : Kërkesë për publikim të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil

AGJENSISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTESIVE

Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ,neni 18 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim shtesat në planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil të Bashkisë Berat për vitin 2026 .

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Ervin Qeca

